



Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues

AKDIE

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri" Pall. Agimi, shk. 16, hyrja 291 Site : www.akdie.org ; email: a.k.d.i.e.albania@gmail.com

Nr. _____ Prot

Tiranë më _____

KONTRATË

PËR ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË ARTISTIT

Sot, më datë _____, në selinë e Agjencisë AKDIE:

POROSITËSI _____, i biri i _____ dhe i _____, i datëlindjes _____, lindur në _____ dhe banues në _____, me adresë banimi _____, me adresë elektronike _____, i identifikuar me kartë _____, me numër llogarie bankare _____, telefon _____.

I POROSITURI Agjencia AKDIE, agjenci e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues, me seli në Tiranë, Bulevardi "Bajram Curri", Pallatet "Agimi", hyrja 16 ap 291, me Drejtor Ekzekutiv Z. Naim Aliaj, e licensuar nga Ministria e Kultures me Urdher nr 434 date 06/07/2018.

Ranë dakord, si vijon:

NENI 1-OBJEKTI I KONTRATËS

AKDIE, detyrohet të kryejë për llogari të porositësit artist interpretues/ekzekutues, veprimet juridike të administrimit kolektiv të të drejtave të artistit interpretues/ekzekutues dhe përfaqësim ligjor të tij, në këtë sistem,

1. sipas të drejtave dhe kompetencave të agjencisë që rrjedhin nga ligji nr. 35/2016 "Për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të",
2. sipas tarifave ligjore të sistemit të administrimit kolektiv,
3. për dhënien e autorizimit të të drejtave të artistit interpretues/ekzekutues për administrimin e të drejtave të tij, në administrimin kolektiv tek Agjencia AKDIE, për llojin e veprave dhe të drejtave për t'u administruar, nga Agjencia AKDIE, për një kohëzgjatje të kontratës, tre vite, e rinovueshme automatikisht, me rinovimin e Licensës së Agjencisë AKDIE.

Drejtoria për të Drejtat e Autorit do të mbikëqyrë dhe do të kontrollojë këtë veprimtari, si organi garant i zbatimit të këtij ligji.

Në periudhën kohore kur administrimi i të drejtave është transferuar në agjencinë e administrimit kolektiv, qoftë me ligj ose me kontratë, artisti nuk mund të administrojë në mënyrë individuale këto të drejta.

NENI 2- TË DREJTAT QË ADMINISTRON AKDIE

Agjencia AKDIE, ka të drejtë të administrojë sipas ligjit, të drejtat si vijon:

A. Administrimi kolektiv i detyrueshëm

- 1) e drejta e transmetimit dhe ritransmetimit për interpretuesit, referuar përcaktimit në pikën 2, shkronja "c", të nenit 130, të këtij ligji;
- 2) e drejta e ritransmetimit të veprave audiovizuale, e përmendur në shkronjën "f", të pikës 1, të nenit 130, të këtij ligji;
- 3) e drejta e qiradhënies për veprat/regjistrimet muzikore, për interpretuesit, referuar në pikën 2, shkronja të nenit 130, të këtij ligji;
- 4) e drejta e shpërblimit për huadhënien publike për interpretuesit, pika 2, shkronja të nenit 130, të këtij ligji;
- 5) e drejta për shpërblim për riprodhimin e kopjeve private dhe përdorimit tjetër personal për interpretuesit, referuar në pikën 2, shkronja "e", të nenit 130, të këtij ligji;
- 6) e drejta për një shpërblim për shpërblim suplementar vjetor, të referuar në nenin 115 të këtij ligji, e përmendur në shkronjën "ë", të pikës 2, të nenit 130, të këtij ligji;

B. Administrimi kolektiv i zgjeruar

- 1) të drejtën për përcjelljen në publik të veprave të fiksuara dhe transmetimet e fonogrameve e të videogrameve;
- 2) të drejtën e paraqitjes publike të një shfaqjeje të fiksuar;
- 3) të drejtën e transmetimit dhe ritransmetimit të një shfaqjeje të fiksuar;
- 4) të drejtën e vënies në dispozicion të publikut të një shfaqjeje të fiksuar;
- 5) të drejtën e qirasë së shfaqjes së fiksuar
- 6) të drejtën për shpërblim së shfaqjes së fiksuar;
- 7) të drejtën për shpërblim për huazim publik të shfaqjes së fiksuar;
- 8) të drejtën për shpërblim të riprodhimit të shfaqjes së fiksuar për qëllime private dhe përdorim personal;
- 9) të drejtën për shpërblim suplementar vjetor, të referuar në nenin 115 të këtij ligji.

NENI 3 -FUNKSIONET E AGJENCISË AKDIE

AKDIE, për llogari të mbajtësve të të drejtave artist interpretues/ekzekutues, në bazë të kompetencave që u janë dhënë dhe sa parashikohet në këtë ligj, kanë këto funksione:

- 1) t'u jap përdoruesve, në vijim të kërkesave të tyre, kontrata në formën joekskluzive për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura, në këmbim të një shpërblimi, me kontratë të shkruar, brenda tagrave të përcaktuar në licencën e agjencisë;
- 2) të mbledh shpërblimin për përdorimin e veprave ose objekteve të të drejtave të lidhura;
- 3) të shpërndajë, në bazë të rregullave të shpërndarjes, shpërblimin e mbledhur nga përdoruesit në mënyrë të drejtë dhe të përpjesëtuar me vlerën dhe përdorimin aktual të veprave e të objekteve të të drejtave të lidhura. Parimet e shpërndarjes së shpërblimit përcaktohen në statutin e agjencisë dhe përjashtohet çdo mundësi arbitrareteti;
- 4) të përfaqësojë mbajtësit e të drejtave, të drejtat e të cilëve ata administrojnë, në procedurat gjyqësore ose administrative dhe të kryejnë çdo veprim tjetër ligjor të nevojshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të administruara nga ato;
- 5) të kryejë çdo veprim tjetër, në përputhje me tagrat e tyre ligjorë dhe të organeve të veta vendimmarrëse, për kompetencat e marra nga mbajtësit e të drejtave;
- 6) të hartojë metodologji të negociueshme për përcaktimin e nivelit të tarifave që subjektet përdoruese duhet të paguajnë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 35/2016;
- 7) të realizojë në emër të artistit interpretues/ekzekutues ose në bazë të kontratës së reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme marrëveshjet e përgjithshme me organizatorët e shfaqjeve, me ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv, me operatorët e rrjetit numerik, që kanë si objekt autorizimin e shfaqjes dhe shpërndarjes për veprat që administron;
- 8) të përfaqësojë interesat e anëtarëve për shfrytëzimin e të drejtave, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke nënshkruar kontratat e reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme;
- 9) të informojë, sipas kërkesës, artistin, për mënyrën e shfrytëzimit të të drejtave, për raportin vjetor financiar dhe atë të kontrollit të të ardhurave financiare, brenda kohës së parashikuar në statut;
- 10) të sigurojë transparencën e veprimtarisë së agjencisë së administrimit kolektiv, në lidhje me autoritetet publike të kontrollit, sipas ligjit;
- 11) për të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit dhe që u paguhet në formë shpërblimi mbajtësve të të drejtave, këto agjenci detyrohen të mbajë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin në burim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat;
- 12) për efekt të përcaktimit të saktë të detyrimeve tatimore, ka detyrimin të vendos në dispozicion të administratës tatimore, sipas formateve të miratuara, informacionin mbi të ardhurat e mbledhura nga përdoruesit e veprave të të drejtave të autorit/të lidhura me to, si dhe shpërndarjen e këtyre shpërblimeve të mbajtësit e të drejtave.

NENI 4-SHPËRBLIMI

Artisti ka të drejtën e përfitimit të shpërblimit, sipas pjesës takuese të kontributit të tij në veprën artistike, mbështetur në skemën statutores të AKDIE, sipas koeficientit të shpërndarjes së përdorimit të veprës artistike në një vit kalendarik, në sasinë e vlerave monetare të hyra në llogarinë bankare të AKDIE nga Sporteli Unik, ku zëri i pagesës së artistit shqiptar dhe të huaj, është jo më pak se 35% të të hyrave, pasi është hequr pagesa tatimore në masën 35% (TVSH dhe Tatim në Burim) dhe kostot e punës së AKDIE, prej 30%.

AKDIE, derdh në llogarinë bankare të Artistit nr. _____ llogarie, Banka _____, vlerën takuese të tij, pasi ka hequr detyrimet tatimore dhe duke përfituar edhe ajo vlerën e punës së saj.

NENI 5-BAZA LIGJORE

Kjo kontratë bazohet në :

1. Kodin Civil, neni 913 e vijues dhe përfshin të gjitha të tagrat e përfaqësimit, pa asnjë kufizim, sipas dispozitave ligjore të përfaqësimit në Kodin Civil, duke përfshirë, jo vetëm veprimet për të cilat është dhënë, por edhe ato akte që janë të domosdoshme për kryerjen e tyre.
2. Ligjin nr. 35/2016 "Për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të".
3. Statutin e Agjencisë AKDIE, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
4. Licenca e Agjencisë AKDIE.

NENI 6-NDALIMI I DISKRIMINIMI I ARTISTIT

- Kjo kontratë është mandat përfaqësimi apo autorizim ligjor, e njëjtë me aktin e pranimit të Statutit të AKDIE-AKT-DIJENIA dhe i jep porositiesit artist, të njëjtën pozitë ligjore, pa asnjë diskriminim, si anëtar statutor i agjencisë AKDIE, duke disponuar për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e një anëtari statutor.

NENI 7-ZGJIDHJA E KONTRATËS DHE MBARIMI I SAJ.

1. Kjo kontratë, zgjidhet me miratimin e palëve ose sipas shkaqeve ligjore, kur AKDIE mund të humbas licensën apo është në fazën e likuidimit apo falimentimit.
2. Kjo kontratë ka afatin e licensës së AKDIE dhe rinovohet automatikisht, sipas ripërtëritjes së licensës së AKDIE.
3. Artisti është i lirë të largohet nga kjo kontratë, sipas rregullave statutores të AKDIE.

POROSITËSI

I POROSITURI/ AKDIE

NAIM ALIAJ

DREJTOR EKZEKUTIV